FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Viti: 2018 – Numri: 190

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E enjte, 3 janar 2019

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 764, datë 27.12.2018	Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2019.....	14979

VENDIM
Nr. 764, datë 27.12.2018

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PËRGJITHSHËM ANALITIK TË PROJEKTAKTEVE, QË DO TË PARAQITEN PËR SHQYRTIM NË KËSHILLIN E MINISTRAVE GJATË VITIT 2019

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 27, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2019, sipas tabelave që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2019
Kryeministri/Zëvendëskryeministri

Nr.	Titulli i projektaktit	Propozues dhe bashkëpropozues	Katër mujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	Lidhja me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian	Lidhja me programin qeverisës 2017-2021	Lidhja me strategjitë kombëtare dhe sektoriale
1	Projektligj "Për informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror""	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (DSIK)	Katërmujori II	Ndryshimet në Politikën e Sigurisë së NATO-s dhe direktivat e saj dhe ligji aktual nuk i parashikon dhe ka vakum ligjor në rregullimin e shumë aspekteve të punës. Përafrimi dhe përshtatja me Politikat e Sigurisë, Direktivat, Rregulloret e BE-së. Përafrimi dhe përshtatja e ligjit të ri, me ndryshimet e ndodhura ndër vite pas miratimit të ligjit të parë, siç është shtimi i kompetencave për kontrollin e figurës së subjekteve të rivlerësimit (Gjyqtarëve e Prokurorëve), me ligjin Nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Shtimi i kategorive të klasifikimit të informacionit, nisur nga praktika ndër vite. Ndryshimi i akteve nënligjore, gjë që sjell vakum në ligjin aktual në fuqi të cilat nuk i rregullon, pasi VKM-të i janë përshtatur politikës së sigurisë së NATO-s, BE-së, si dhe direktivave, rregulloreve mbështetëse të tyre.	Përcaktimi i rregullave të përgjithshme që duhet të zbatohen gjatë gjithë ciklit të punës me informacionin e klasifikuar, si element i rëndësishëm i sigurisë kombëtare duke respektuar të drejtat e liritë themelore të njeriut, legjislacionin e mbrojtjen e interesave të Republikës së Shqipërisë në përmbushjen e angazhimeve ndërkombëtare të shtetit shqiptar. Krijimi i një sistemi unik për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar që ka të bëj me cenimin e interesave të sigurisë kombëtare të Republikës së Shqipërisë. Parashikimi i kompetencave të reja që i janë shtuar DSIK-së (kontrolli i figurës së gjyqtarëve dhe prokurorëve). Rregullave për sigurimin e personelit, sigurimin industrial, sigurimin e dokumenteve të klasifikuara, shumfizimi, qarkullimi, sigurimin fizik, transportimin e informacionit të klasifikuar, arkivimin e tij, sigurimin e sistemeve të komunikimit dhe informacionit, shkëmbimi i informacionit, shkeljet e rregullave të sigurisë dhe sanksionet.	Kapitulli 31	-	Strategjia e Sigurisë Kombëtare për ndërtimin e rrjetit kombëtar të komunikimit të sigurt
2	Projektvendim "Për miratimin e rregullores për klasifikimin e informacionit "Sekret shtetëror""	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (DSIK)	Katërmujori I	Ky projektvendim ka për qëllim përcaktimin e kritereve dhe procedurave për klasifikimin "Sekret shtetëror" të informacioneve që prodhojnë institucionet shtetërore. Vendimi aktual edhe pse ka pësuar ndryshime është e nevojshme të përditësohet më tej.	Projektvendimi përcakton mënyrën së si ngrihen Komisionet për Shqyrtimin dhe Klasifikimit të Informacioneve, si funksionojnë dhe ku ngrihen ato. Gjithashtu përcaktohen kriteret dhe kategoritë e informacioneve që duhet të klasifikohen "Sekret shtetëror", hartimi i listës së informacioneve të klasifikuar "Sekret shtetëror". Në projektvendim do të përcaktohen në mënyrë më të detajuar cili do të jetë rrethi i çështjeve mbi të cilat mund të klasifikohen informacione. Kjo do të ndihmojë institucionet shtetërore në përcaktimin e listës së dokumenteve që do të klasifikojnë. Në projektvendim do të përcaktohet më saktë roli i Drejtorit të DSIK në rastet kur informacioni që kërkojnë të klasifikojnë institucionet nuk ka lidhje me sigurinë kombëtare.	-	-	-
3	Projektvendim "Për disa ndryshime në vendimin nr.15, datë 121.2018 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e tarifave për shërbimet elektronike të agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit"	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (AKSHI), Ministri i Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori I	Ofrimi i nënshkrimit elektronik në mënyrë "Remote Signing" (*dhe jo me usb token sikurse është kryer deri me tani*) si rezultat i të cilit ndryshojnë dhe tarifat e përcaktuara për shërbimet elektronike të AKSHI-t.	Nëpërmjet këtij projekt-akti AKSHI do të gjenerojë nënshkrime elektronike në mënyrë "*Remote Signing*" (dhe jo me *usb token* sikurse është kryer deri me tani). Si rezultat i këtij fakti do të përfitohet: -Ulja e kostove monetare, duke reduktuar numrin e kopjeve dhe qarkullimin e dokumentit brenda strukturave ndërinstitucionale dhe brenda institucionit/kompanisë; • Autentifikimi i përdoruesit në një website/e-service; • Rritja e shpejtësisë dhe sigurisë së shkëmbimit të dokumentit; • Firmosja e dokumenteve kudo nga çdo pc/laptop/tabletë/mobile, duke eliminuar diferencat gjeografike dhe kohore; • Rrit disponueshmërinë e dokumenteve, duke eliminuar proceset si printimi dhe skanimi; • Përmirëson reputacionin e institucionit/kompanisë/subjektit;	-	-	-
4	Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 13/2016 "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ADISA)	Katërmujori III	Përmirësimi i mënyrës së organizimit dhe funksionimit të ADISA-s si dhe harmonizimin me përcaktimet e K.Pr.A dhe Direktivës së BE-së 2006/123 / EC të datës 12 dhjetor 2006 "Për shërbimet në tregun e	1. Saktësimin dhe unifikimin e terminologjisë së përdorur në përcaktimet aktuale të ligjit; 2. Rregullimin e varësisë, statusit, organizimit dhe kompetencave të ADISA-s dhe organeve drejtuese të saj;	Kap 3 "E drejta e vendosjes dhe liria e ofrimit të shërbimeve"	Kreu III "Shërbimet publike", pika 3.1 "Shteti ligjor dhe drejtësia e re" të Programit politik qeverisës 2017 - 2021.	1. Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën publike 2015 – 2020; 2. Dokumenti i politikave afatgjata për ofrimin e shërbimeve me në qendër qytetarin nga administrata shtetërore në Shqipëri;

	Shqipërisë""			brendshëm."	3. Përcaktimi në mënyrë shteruese i formave, mënyrave dhe kanaleve nëpërmjet të cilave ofrohen shërbimet publike në sportel; 4. Saktësim i procedurës, afateve dhe përcaktimeve lidhur me trajtimin e ankesave apo vendosjen e tarifave për shërbimin e sportelit.			
5	Projektvendim "Për standardizimin e rregullave, mënyrave, procedurave, njësive përgjegjëse për paraqitjen dhe për shqyrtimin e ankimeve ndaj ofrimit të shërbime publike"	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ADISA)	Katërmu jori I	Standardizimi i rregullave, mënyrave dhe procedurave për paraqitjen dhe shqyrtimin e ankimeve, që paraqiten nga përfituesit e shërbimeve, në rastet kur zyrat përgjegjëse nuk ofrojnë shërbimin e kërkuar ose nuk e ofrojnë atë në mënyrën e duhur, si edhe rregullimi i mënyrës së raportimit të të dhënave në lidhje me ankesat që janë paraqitur në një institucion. Akt i propozuar në zbatim të nenit 35, pika 2 germa "ç" dhe nenit 36, pika 4 e ligjit nr. 13/2016 "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë".	Përcaktimi dhe garantimi i një mjeti efektiv ankimi, ndaj veprimeve apo mosveprimeve të organeve publike gjatë procesit të ofrimit të shërbimeve publike, si dhe të vendose rregullat për përcaktimin e njësive përgjegjëse për shqyrtimin e ankimeve, të cilat janë të ndryshme nga zyra përgjegjëse për ofrimin e shërbimit.	-	Kreu III "Shërbimet publike", pika 3.1 "Shteti ligjor dhe drejtësia e re" të Programit politik qeverisës 2017 - 2021.	1. Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën publike 2015 – 2020; 2. Dokumenti i politikave afatgjata për ofrimin e shërbimeve me në qendër qytetarin nga administrata shtetërore në Shqipëri;
6	Projektvendim "Për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimit dhe rezultateve në punë"	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ADISA)	Katërmu jori I	Përcaktimi i autoritetit përgjegjës për vlerësimin e cilësisë në zbatim të përcaktimeve të nenit 34 pika 4 e ligjit nr. 13/2016 "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë".	Përcaktimi i ADISA-s si autoriteti përgjegjës për vlerësimin e cilësisë dhe rezultateve në punë duke përcaktuar edhe kriteret mbi bazën e të cilave do të kryhet ky vlerësim.	-	Kreu III "Shërbimet publike", pika 3.1 "Shteti ligjor dhe drejtësia e re" të Programit politik qeverisës 2017 - 2021.	1. Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën publike 2015 – 2020; 2. Dokumenti i politikave afatgjata për ofrimin e shërbimeve me në qendër qytetarin nga administrata shtetërore në Shqipëri;
7	Projektvendim "Për riinxhinerimin e shërbimeve publike"	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ADISA)	Katërmu jori II	Përcaktimi i rregullave të hollësishme për procedurën e ndërmarrjes së nismës dhe bashkëpunimit të institucioneve në procesin e riinxhinierimit dhe kompetencën për realizimin e tij në zbatim të nenit 42, pika 3 e ligjit nr. 13/2016 "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë".	Përcaktimi i institucioneve përgjegjëse për zhvillimin e procedurës së riinxhinierimit; Subjektet të cilat kanë të drejtën për të filluar procedurën e riinxhinierimit; Detyrat përkatëse të ADISA-s, AKSHI-t dhe institucioneve që marrin pjesë në këtë proces; Mënyrat e bashkëpunimit ndërinstitucional.	-	Kreu III "Shërbimet publike", pika 3.1 "Shteti ligjor dhe drejtësia e re" të Programit politik qeverisës 2017 - 2021.	1. Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën publike 2015 – 2020; 2. Dokumenti i politikave afatgjata për ofrimin e shërbimeve me në qendër qytetarin nga administrata shtetërore në Shqipëri;
8	Projektvendim "Për kalimin e funksioneve të sporteleve të shërbimit në administrimin e Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)"	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ADISA)	Katërmu jori I	Kalimi i funksioneve të sporteleve të disa institucioneve në administrimin e ADISA-s nëpërmjet një akti të vetëm nënligjor pa patur nevojë për miratimin e akteve të ndryshme nënligjore për kalimin e shërbimeve të secilit institucion të përcaktuar (sikundër ndodh aktualisht). Kjo mënyrë krijon lehtësira në ofrimin e shërbimeve nga ADISA sipas parimit të ndarjes FO - BO si dhe sjell shtimin e shërbimeve që ofrohen në sportelet e saj.	Miratimin e kalimit të funksioneve të sporteleve të disa institucioneve në administrimin e ADISA-s; Përjashtimin e disa shërbimeve të cilat për shkak të natyrës nuk mund të ofrohen në sportelet e ADISA-s duke parashikuar edhe mundësinë që deri në konsolidimin e ofrimit të shërbimeve dhe ngritjes së sporteleve të ADISA-s në territorin e Republikës së Shqipërisë, këto shërbime do të vazhdojnë të ofrohen nga vetë institucionet; Autorizimin e nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet ADISA-s dhe institucioneve me qëllim detajimin e formës së bashkëpunimit.	-	Kreu III "Shërbimet publike", pika 3.1 "Shteti ligjor dhe drejtësia e re" të Programit politik qeverisës 2017 - 2021.	1. Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën publike 2015 – 2020; 2. Dokumenti i politikave afatgjata për ofrimin e shërbimeve me në qendër qytetarin nga administrata shtetërore në Shqipëri;
9	Projektvendim "Për disa ndryshime në vendimin nr.69 , date 27.1.2016 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara"	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (AKCESK)	Katërmu jori III	Rregullim i fushës me specifikimet përkatëse sipas standardeve ndërkombëtare	Metoda remote; transferimi i shërbimeve të palët e treta	-	Në zbatim të kuadrit ligjor që rregullon fushën e shërbimeve të besuara në RSH.	-
10	Projektvendim "Për disa ndryshime në vendimin nr.222, datë 26.4.2018 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës për identifikimin e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit"	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (AKCESK)	Katërmu jori III	Rishikim i listës së infrastrukturave	Shtese të listës për infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme të informacionit	-	Në zbatim të ligjit nr. 2/2017 "për sigurinë Kibernetike"	Në përputhje me Strategjinë për Sigurinë Kombëtare

11	Projektvendim "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike"	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (AKCESK)	Katërmu jori III	Detyre funksionale e AKCESK (VKM nr. 141/ 2017 "Për organizimin dhe funksionimin e AKCESK")	Ndërveprimi i institucioneve publike në fushën e sigurisë kibernetike dhe masa konkrete të matshme dhe të kostuara për çdo institucion.	-	Në përputhje me ligjin nr. 2/2017 "Për sigurinë Kibernetike" dhe Strategjinë për Sigurinë Kombëtare	-
12	Projektvendim "Për miratimin e kufijve territorialë e hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe qendrën e përbërjen e Këshillit të secilit prej tyre"	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (AMBU)	Katërmu jori I	1. Kërkesë ligjore; 2. Rregullimi i territorit hidrografik me qëllim rritjen e eficencës së menaxhimit të burimeve ujore	Akti nënligjor parashikon të ndryshoj kufij territorial dhe hidrografikë të baseneve ujore si edhe përbërjen e KBU	-	-	-
13	Projektvendim "Për miratimin e planit të menaxhimit të basenit ujor Drin-Buna"	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (AMBU)	Katërmu jori II	Kërkesë ligjore	Akti nënligjor parashikon që planet e menaxhimit të baseneve ujore hartohen në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe zbatohen për një territor dhe periudhë të përcaktuar.	Kapitulli 27	-	VK, nr.73, datë 07.02.2018 "Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Burimeve Ujore"
14	Projektvendim "Për miratimin e planit të menaxhimit të basenit ujor Seman"	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (AMBU)	Katërmu jori II	Kërkesë ligjore	Akti nënligjor parashikon që planet e menaxhimit të baseneve ujore hartohen në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe zbatohen për një territor dhe periudhë të përcaktuar.	Kapitulli 27	-	VKM nr.73 datë 07.02.2018 "Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Burimeve Ujore"
15	Projektvendim "Për përcaktimin e zonave, distancave dhe gjerësive të brigjeve të burimeve ujore"	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (AMBU)	Katërmu jori III	Kërkesë ligjore	Akti nënligjor parashikon përcaktimin e zonave, distancave dhe gjerësive të brigjeve të burimeve ujore	-	-	VKM nr.73, datë 07.02.2018 "Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Burimeve Ujore"
16	Projektvendim "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimi për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore"	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (AMBU)	Katërmu jori I	Kërkesë ligjore	Akti nënligjor parashikon që organet e administrimit të burimeve ujore të japin autorizime, leje dhe lidhin kontrata koncesioni për përdorimin e ujërave, duke u bazuar në parimet e proporcionalitetit, eficiencës dhe deburokratizimit, në zvogëlimin e barrierave administrative	-	-	VKM nr.73, datë 07.02.2018 "Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Burimeve Ujore"
17	Projektvendim "Për disa ndryshime në vendimin nr.221, datë 26.4.2018 të Këshillit të Ministrave "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore""	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (AMBU)	Katërmu jori II	Ndryshimi i aktit nënligjor vjen si kërkesë e përshtatjes me sistemin E-Leje	Akti nënligjor parashikon ndryshimin dhe plotësimin e procedurës së aplikimit dhe shqyrtimit për leje ose autorizim nëpërmjet sistemit E-Leje	-	-	-
18	Projektvendim "Për një ndryshim në vendimin nr.662, datë 21.09.2016 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e tarifave të përdorimit të ujit dhe të shkarkimeve të lëngëta"	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (AMBU)	Katërmu jori I	Ndryshim i aktit nënligjor si pasojë e ndryshimeve institucionale në sektorin e ujit	Akti nënligjor parashikon ndryshimin e referencave të emërtimeve të institucioneve të reja të krijuara në sektorin e ujit	-	-	-
19	Projektvendim "Për një ndryshim në vendim nr.590, datë 18.10.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Ujit"	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (AMBU)	Katërmu jori I	Përshtatja e ndryshimeve institucionale si pasojë e ndryshimeve të fushave të përgjegjësive të ministrive	Akti nënligjor parashikon të ndryshoj përbërjen e Këshillit Kombëtar të Ujit duke reflektuar ndryshimet e fushave të përgjegjësive të ministrive	-	-	-
20	Projektvendim "Për mbështetjen për Kultet Fetare"	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (Komiteti Kulte)	Katërmu jori I	Përcaktimin e masës së financimit nga buxheti i shtetit për bashkësitë fetare që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave në zbatim të ligjit Nr. 10140, datë 15.05.2009	Mbështetje financiare buxhetore për bashkësitë fetare për garantimin e së drejtës së besimit fetar	-	Pika 2.6, "Kultura dhe turizmi kulturor"	"Strategjia ndërsektoriale e luftës kundër terrorizmit dhe plani i veprimit 2016 - 2020"

21	Projektligj "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (DAP)	Katërmu jori III	Si rezultat i miratimit nga Komiteti Drejtues për Ristrukturimin e Institucioneve të Varësisë, i tipologjisë së këtyre institucioneve, del si detyrim ndryshimi i ligjit aktualisht në fuqi, konkretisht ligji 90/2012.	Rregullimi i parimeve, si dhe mënyrës së krijimit, organizimit, funksionimit dhe tipologjisë së institucioneve të administratës shtetërore	-	-	Strategjia Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2015 - 2020, miratuar me vendimin nr. 319, date 15/04/2015, të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar. Objekti 4, sipas lidhjes 1/1, Pani i aktiviteteve dhe treguesit për periudhën 2018 – 2020".
22	Projektvendim "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese""	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (DAP)	Katërmu jori III	Detyrim ligjor	Disa ndryshime në lidhje me mënyrën e vlerësimit të jetëshkrimit të kandidateve	-	-	-
23	Projektvendim "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive"	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (DAP)	Katërmu jori III	Detyrim ligjor	Disa ndryshime në lidhje me mënyrën e vlerësimit të jetëshkrimit të kandidateve	-	-	-
24	Projektvendim "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 138, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për rregullat e organizimit e të funksionimit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe trajnimin e nëpunësve civil", të ndryshuar	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ASPA, DAP)	Katërmu jori II	Zbatimi i projektit për ristrukturimin e institucioneve të varësisë	1- Disa ndryshime që lidhen me kalimin e funksioneve dhe kompetencave të Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore, tek ASPA dhe shkrirjen e kësaj qendre. 2- Disa rregullime në lidhje me kompetencat e Këshillit Drejtues të ASPA-s dhe të drejtorit të ASPA-s në lidhje me programet e trajnimit të saj, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar.	-	-	-
25	Projektvendim "Për emërimin e anëtarëve të Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes për TND-në"	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (DAP)	Katërmu jori I	Detyrim ligjor për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes për TND-ne	Emërimin e anëtarëve të KKP për TND, për arsye të mbarimit të mandatit të dy prej anëtarëve të këtij komisioni	-	-	-
26	Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10 433 datë 16.06.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë""	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (Inspektorati Qendror)	Katërmu jori I	Për përmirësimin e procedurës së inspektimit dhe statusit të inspektorëve.	Procedura i inspektimit si një proces i rregullt administrativo ligjor: bazuar në metodologjinë e analizës së riskut, me dokumente standarde, me checklista, me tableta, online	-	Reforma në Institucionet e Varësisë (përfshirë Inspektoratet dhe Agjencitë të cilat kryejnë funksione inspektuese), Është ngritur Komiteti Drejtues për Reformimin e Institucioneve të Varësisë drejtuar nga Zv. Kryeministri Znj. Senida Mesi	Përmirësimin e koordinimit të zbatimit të strategjitë Antikorrupsion; Angazhimet e Qeverise Shqiptare në Samitin e Londrës
27	Projektvendim "Për Planin Kombëtar të Veprimit të Strategjisë Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm"	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (Qendra KKEDH)	Katërmu jori I	Përditësimi i detyrimeve të ministrive të linjës, në zbatim të Strategjisë Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm	Masat e marra nga çdo ministri e linjës, në përmbushje të detyrimeve relevante.	Prioritetet kryesore për Kapitullin 24	-	Në përputhje me Strategjinë Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm
28	Projektligj "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9154, datë 6.11.2013 "Për arkivat"	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (DPArkivave)	Katërmu jori II	Përcaktimet aktuale ligjore përbëjnë problem, në disa drejtime. Së pari, nuk përcaktohet qartë së ku përfundon dokumentacioni i një autoriteti të krijuar nga Parlamenti, duke lënë hapësirë interpretative mbi disa arkiva të përhershëm historik. Së dyti, lë hapësirë që çdo autoritet kushtetues të ketë arkivin e vetë të përhershëm historik, duke rritur artificialisht numrin e këtyre arkivave edhe përtej atyre të përcaktuar më sipër. Së treti, nuk ka përcaktime për arkiva të posaçme si Autoriteti që funksionojnë në bazë të ligjit të tyre. Së	1. Harmonizim i legjislacionit mbi punën me dokumentet, konkretisht: a. Zgjidhje e mospërputhjeve mes ligjit "Për arkivat" dhe legjislacionit për të drejtën e informimit b. Zgjidhje e mospërputhjeve mes ligjit "Për arkivat" dhe legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale c. Zgjidhje e mospërputhjeve mes ligjit "Për arkivat" dhe legjislacionit për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror" d. Plotësimi i legjislacionin mbi dokumentin	-	Pika 3.1.1, administrata publike dhe digjitalizimi, duke I hapur rrugë sistemeve elektronike të menaxhimit të dokumentacionit dhe duke përcaktuar procedurat për to. Krijimi I databazave bazuar mbi arkivat fizikë, përmes arkivave qendrore në veprim. Modernizimi i administratës shtetërore.	-

				katërti, cenon parimin e unitetit të fondit arkivor, duke bërë që dokumentacioni i një fondkrijuesi të jetë në disa arkiva (shembull: Arkivi i Kuvendit përpara vitit 1991 është në AQSH, pas këtij viti në Kuvend). Së pesti, ndan artificialisht fonde arkivore të ngjashme, që studiuesve ju duhen njëkohësisht (Arkivi i Sistemit të Drejtësisë duhet të ruajë ligjërisht dokumentacionin e çdo gjykate dhe prokurorie, por jo të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe Prokurorisë së Përgjithshme, që janë organe kushtetuese dhe duhet të kenë arkiv të përhershëm pranë tyre). Së gjashti, nuk përcakton çfarë ndodh me institucione shtetërore që janë organe kushtetuese e më vonë pushojnë së qëni të tilla (shembull: KQZ). Së shtati, nuk parashikon së çfarë ndodh me dokumentacion që bëhet historik pas një periudhë të gjatë kohe (sipas ligjit dorëzohen pas 75 vitesh në arkivin e përhershëm historik dokumentet që i duhen qytetarit gjatë gjithë jetës, të tilla si dokumente të gjendjes civile, amzat, borderotë etj.), duke bërë që për të zgjidhur këtë ngërç të ngrihej si arkiv tipologjie (i përhershëm historik) Arkivi Qendror i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, kur ai kryen funksioNë të një arkivi në veprim, teksa shërben dokumentacion johistorik, por për efekt nevojash sociale e juridike të qytetarëve. Nga ana tjetër, kjo bën që ky dokumentacion të mos mund të shfrytëzohet nga studiuesit, pas kalimit të afatit maksimal të ligjit. Prandaj, është propozuar krijimi i arkivave qendrore në veprim, ku do të përfshihet edhe, por jo vetëm, AQ i ISSH-së.	elektronik, duke rregulluar çështje që kanë të bëjnë me evidencimin dhe arkivimin e tij 2. Çështje mirfilltazi arkivore, të cilat kanë nevojë për shqyrtim, përkatësisht: a. Afati i dorëzimit të dokumenteve b. Garantimi i parimit të operativitetit, duke ndarë qartazi arkivat në veprim dhe arkivat historikë; përfshi edhe nëpërmjet krijimit të arkivave qendrore në veprim c. Garantimi i ruajtjes së dokumentacionit të prodhuar nga privati, në funksion apo për interes publik. d. Rregullimi i problematikave mbi punën me dokumentet në arkivat në veprim dhe profesionin e arkivistit 3. Shqyrtim i mundësive për riorganizimin e Rrjetit Arkivor të Republikës së Shqipërisë.			
29	Projektvendim "Për disa ndryshime në vendimin nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar"	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (AZHT)	Katërmujori III	Përmirësimin e vazhdueshëm të ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarit nëpërmjet sistemit E-Leje	Tipologjitë e ndërtimeve, vendimmarrja për të cilat janë kompetencë e KKT-se. Dispozitat për miratimin e Certifikatë së përdorimit. Afatet procedurale.	-	-	-
30	Projektvendim "Për disa ndryshime në vendimin nr.725, datë 02.09.2015 të Këshillit të Ministrave "Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar"	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (AZHT)	Katërmujori III	Ndryshimi i varësisë së AZHT-së nga Ministria e Zhvillimit Urban tek Kryeministri. Ndryshimet që ndodhën në legjislacionin mbi varësinë administrative të punonjësve të IT.	Kategoria e pagave të punonjësve dhe numri i përgjithshëm i tyre	-	-	-

Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2019
Ministria e Brendshme

Nr.	Titulli i projektaktit	Ministri propozues dhe bashkëpropozues	Katër mujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	Lidhja me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian	Lidhja me programin qeverisës 2017-2021	Lidhja me strategjitë kombëtare dhe sektoriale
1	Për miratimin e Planit Kombëtar për Migracionin	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Miratimi i këtij Plani synon përcaktimin e reformave në fushën e migrimit për menaxhimin e suksesshëm të kësaj dukurie, si dhe të përcaktojë, me hollësi, objektivat, veprimtaritë, rolet e përgjegjësitë institucionale dhe efektin financiar për zbatimin e këtij plani.	Përcaktimi i reformave në fushën e migrimit për menaxhimin e suksesshëm të kësaj dukurie, si dhe të përcaktojë, me hollësi, objektivat, veprimtaritë, rolet e përgjegjësitë institucionale dhe efektin financiar për zbatimin e këtij plani.	-	3.1 Shteti Ligjor dhe Drejtësia e re-Rendi dhe siguria publike	-
2	Për sigurimin e jetës së punonjësve të Policisë së Shtetit	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Akt nënligjor që duhet të miratohet në zbatim të Ligjit 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, neni 71.	Përfitimi i sigurimit të jetës së punonjësit të policisë, në rast aksidenti në detyre ose për shkak të detyrës	-	3.3 Shëndetësia dhe kujdesi social.	Strategjia e Rendit Publik 2015-2020
3	Projektligj "Për shtetësinë"	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Nevoja e harmonizimit të kuadrit ligjor të shtetësisë me legjislacionin në fuqi që prek çështjet e shtetësisë.	Projektligji i propozuar, synon trajtimin në mënyrë më të plotë të mënyrave të fitimit, rifitimit dhe heqjes dorë nga shtetësia shqiptare.	-	3. Shërbimet publike	-
4	Për trajtimin ekonomik e financiar të familjeve të punonjësve të policisë, që humbin jetën për shkak të detyrës	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Akt nënligjor që duhet të miratohet në zbatim të Ligjit 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, neni 75.	Sigurimi i trajtimit ekonomik, financiar, banese falas, për familjet e punonjësve të policisë që humbasin jetën.	-	3.3 Shëndetësia dhe kujdesi social.	-
5	Për miratimin e rregullave dhe procedurave që ndiqen nga Prefekti i Qarkut, në rast mospërmbushjeje nga strukturat përgjegjëse të njësive të vetëqeverisjes vendore të detyrimeve të përcaktuara në nenin 29, të ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004 "Për sistemin e adresave, të ndryshuar"	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Akt nënligjor në zbatim të ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004 "Për sistemin e adresave", të ndryshuar	Miratimi i rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga Prefekti i Qarkut, në rast mospërmbushjeje nga njësitë e vetëqeverisjes vendore të detyrimeve të përcaktuara në nenin 29 të ligjit nr. 9270, datë 29.7.2004 "Për sistemin e adresave", të ndryshuar.	-	3. Shërbimet publike	-
6	Për standardizimin dhe rregullat për vendosjen e emrave të bulevardeve, rrugëve, rrugicave, shesheve dhe parqeve në Republikën e Shqipërisë	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Akt nënligjor në zbatim të ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004 "Për sistemin e adresave", të ndryshuar	Miratimi i rregullave standarde për vendosjen e emrave të bulevardeve, rrugëve, rrugicave, shesheve dhe parqeve në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr. 9270, datë 29.7.2004 "Për sistemin e adresave", të ndryshuar	-	3. Shërbimet publike	-
7	Për miratimin e llojeve të shërbimeve shtese që ofron PSH., për personat juridikë e fizikë, publik ose privat dhe tarifave të pagesës për këto shërbime	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Akt nënligjor që duhet të miratohet në zbatim të ligjit 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, neni 81.	Ofrimi i shërbimeve kundrejt pagesës, për persona juridikë publik ose privat, mbi bazën e kërkesave të tyre.	-	3. Shërbimet publike	Strategjia e Rendit Publik 2015-2020
8	Për trajtimin me kredi me interes të butë për strehim të punonjësve të Policisë së Shtetit	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Akt nënligjor, në zbatim të Ligjit 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, neni 69.	Përftimi për punonjësit e policisë së shtetit, kredi në masën 3% për strehim	-	3. Shërbimet publike	-
9	Përmirësimi i shërbimit të autotransportit në funksion të programit të mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Në kuadër të Ligjit 10173, datë 22.10.2009 "Për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë", synohet shtimi në inventar i 4 (katër) automjeteve të blinduara që do të përdoren në funksion të masave së mbrojtjes fizike të personave të mbrojtur gjatë lëvizjeve për në organet e drejtësisë (për dhënien e dëshmisë) nga vendi i akomodimit.	Rregullimi i shërbimit të transportit, sipas standardeve të punës të njësive partnere të rajonit, në funksion të garantimit të jetës si të punonjësve të policisë dhe personave të mbrojtur.	-	Lufta Kundër Krimit të Organizuar	-
10	Për miratimin e Rregullores së Shërbimit të MZSH.	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Akt nënligjor në zbatim të ligjit nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin". Miratimi i rregullave për disiplinën, etikën, marrëdhënien e punës dhe çështje të tjera të parashikuara në ligj.	Disiplina, etika, marrëdhëniet e punës dhe çështje të tjera, sipas autorizimit ligjor.	-	3.1 Shteti Ligjor dhe Drejtësia e re-Rendi dhe siguria publike	-
11	Për përcaktimin e kritereve, masës së përfitimit dhe llojet e pushimeve të tjera, me apo pagesë në shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Akt nënligjor në zbatim të ligjit nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin".	Përcaktimi i kohës së punës dhe pushimit për punonjësit e shërbimit të MZSH-së, i kritereve të përfitimit të pagës për orët shtesë të punës.	-	3.1 Shteti Ligjor dhe Drejtësia e re-Rendi dhe siguria publike	-

12	Për organizimin, funksionimin dhe fushën e veprimit të policimit vullnetar	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Projektkati ka referencë dhe del në zbatim të Ligjit nr.108/2014 "Për Policinë e Shtetit, i ndryshuar, në zbatim të nenit 76 pika Përfshirja e komunitetit në policim. Rritja e standardeve të sigurisë në komunitet. Përcaktimi i rregullave për organizimin, funksionimin dhe fushën e veprimit për policimin vullnetar.	Bashkëpunimi i Policisë së Shteti me komunitetin për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike, parandalimin e krimit dhe përballimin e situatave të emergjencave civile.	-	3.1 Shteti Ligjor dhe Drejtësia e Re, Rendi dhe Siguria Publike	Strategjia e Rendit Publik 2015-2020
13	Për sigurimin e jetës të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Akt nënligjor në zbatim të Ligjit 152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin" (neni 32)	Projekt VKM përcakton detyrimin e Institucionit të bashkisë, që nëpërmjet kompanive të sigurimit, të bëj sigurimin e jetës së punonjësit zjarrfikës, në rast të dëmtimeve trupore gjatë kryerjes së detyrës, që mund të sjellin humbje të jetës apo paaftësi të përhershme/përkohshme, të shkaktuar nga aksidentet apo ngjarje gjatë shuarjes së zjarreve apo ndërhyrjeve për shpëtim në fatkeqësi apo aksidente të ndryshme.	-	3.3 Shëndetësia dhe kujdesi social.	-
14	Për miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë "Mbi ngritjen dhe funksionimin e një qendre kontakti të përbashkët për bashkëpunim policor dhe doganor".	Ministri i Brendshëm, Ministri i Financave dhe Ekonomisë	Katërmujori II	Projektmarrëveshja duhet të miratohet në kuadër të bashkëpunimit policor dhe doganor ndërmjet dy vendeve.	Ngritja e Qendrës së përbashkët të kontaktit dhe përcaktimi i rregullave për funksionimin e saj.	-	3.1 Shteti Ligjor dhe Drejtësia e re-Rendi dhe siguria publike	-
15	Projektligj "Për Ratifikimin e Konventës së Gjenevës të vitit 1929 Për Shtypjen e Falsifikimit të Monedhës"	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Ku projektligj synon aderimin e RSH në Konventën e Gjenevës së vitit 1929	Aderimi në konventën e Gjenevës	Po, Kapitulli 24	3.1 Shteti Ligjor dhe Drejtësia e re-Rendi dhe siguria publike	-
16	Projektligj "Për kundërvajtjet administrative kundër rregullave të bashkëjetesës shoqërore"	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Nëpërmjet këtij projektligji synohet të përcaktohen kompetenca të reja për PSH me qellim zgjidhjen efektive të shqetësimeve të qytetareve dhe sipërmarrjes	Nxitja e respektimit të rregullave të bashkëjetesës shoqërore, në fushën e sigurisë, qetësisë, moralit publik	-	3.1 Shteti Ligjor dhe Drejtësia e Re, Rendi dhe Siguria Publike	Strategjia e Rendit Publik 2015-2020
17	Projektligj "Për policinë bashkiake"	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Harmonizimin dhe unifikimin e kompetencave të Policisë së Shtetit me Policinë bashkiake, në fushën e kundërvajtjeve administrative kundër rregullave të bashkëjetesës shoqërore	Nxitja e respektimit të rregullave të bashkëjetesës shoqërore, në fushën e sigurisë, qetësisë, moralit publik	-	3.1 Shteti Ligjor dhe Drejtësia e Re, Rendi dhe Siguria Publike	Po, Strategjia e Decentralizimit dhe Vetëqeverisjes Vendore
18	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin Nr. 256, datë 25. 3. 2015, të Këshillit të Ministrave "Për kompensimin për privacionet dhe humbjet që i shkaktohen punonjësit të Policisë së Shtetit, për shkak të nevojave të punës dhe të shërbimit"	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	N Problematika të evidentuara në lidhje me trajtimin e financiar të punonjësve të policisë që emërohen larg vendbanimit.	Trajtim financiar i njëjtë për punonjësit e transferuar/ emëruar larg vendbanimit	-	-	-
19	"Për disa shtesa e ndryshime në vendimin nr. 892, datë 21.12.2016 të Këshilli të Ministrave "Për përcaktimin e funksioneve korresponduake dhe kategorizimi për gradat në PSH""	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Detyrim që lind nga pika 1 e neni 61 të Ligjit nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar.	Shtimi i punonjësve me gradë inspektor I dhe inspektor i II, ka diktuar nevojën e kategorizimit të këtyre gradave në funksionet korreponduese	-	-	-
20	Projektligj "Për disa ndryshime në ligjin nr. 121/2014 "Për azilin në Republikën e Shqipërisë"	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Ky projektligj synon të përafrojë më tej procedurat në kuadër të mbrojtjes ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë me *acquis* të Bashkimit Evropian dhe të fuqizojë sistemin e azilit në vend në përputhje me këto standarde.	Përafrimi i mëtejshëm i procedurave për dhënien e statusit të refugjatit dhe të mbrojtjes plotësuese në Republikën e Shqipërisë me *acquis* të Bashkimit Evropian, i procedurave për kategori të veçanta dhe vulnerabël, si dhe fuqizimi i sistemit të azilit në vend në përputhje me këto standarde.	Po, Kapitulli 24	3.1 Shteti Ligjor dhe Drejtësia e re-Rendi dhe siguria publike	-
21	Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin 71/2016 "Për kontrollin Kufitar" .	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Ndryshimet lidhen me aplikimin e sistemit për Informacionin e Avancuar për Pasagjerët (API), në përputhje me Direktivën 2004/82 të BE për API, Rezolutave 2178 dhe 2309 të Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara dhe Standardit të ri 9.5 të ICAO	Projektakti synon përafrimin e direktivës 2004/82, i cili parashikon aplikimin e sistemit të informacionit të avancuar për pasagjeret	Po, Kapitulli 24	3.1 Shteti Ligjor dhe Drejtësia e re-Rendi dhe siguria publike	-
22	Për miratimin e Planit të Veprimit 2018-2020, të Strategjisë së Rendit Publik 2015-2020.	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Qëllimi është zhvillimi i standardeve të organizatës së Policisë, për të ndërtuar një polici sipas modelit e parimeve të policimit demokratik, me përgjegjësi të plota, të unifikuar,	Realizimi i reformës në Policinë e Shtetit.	-	3.1 Shteti Ligjor dhe Drejtësia e Re, Rendi dhe Siguria Publike	-

				të besueshme nga komuniteti, të aftë dhe funksionale për kontrollin e zbatimit të ligjit në të gjithë territorin e vendit dhe për hetimin e krimit.				
23	Për përcaktimin e kritereve dhe masës së përfitimit të pagesës së qirasë për strehim.	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Akt nënligjor në zbatim të nenit 70 pika 2 e ligjit nr. 108/2014	Realizimi i reformës në Policinë e Shtetit.	-	3.3 Shëndetësia dhe kujdesi social.	-
24	Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 70/2014 "Për shërbimin e çështjeve të brendshme dhe ankesat"	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Përmirësimi i ligjit organik, harmonizimi i tij me ligjin nr. 12/2018 "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, SHÇBA, Gradës së Republikës së Shqipërisë"	Harmonizimi i ligjit me standardet dhe praktikat me të mira të BE dhe ndërkombëtare	-	3.1 Shteti Ligjor dhe Drejtësia e re-Rendi dhe siguria publike	-
25	Projektligj "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Nevojë e institucionit për përmirësimin e shërbimit të sigurisë së personaliteteve të larta shtetërore.	Përcaktimi me ligj të veçantë dhe të integruar i organizimit dhe funksionimit të Gardës së Republikës së Shqipërisë, në veçanti i shërbimit të Sigurisë së Personaliteteve dhe të Objekteve të Rëndësisë së Veçantë, i sistemit të gradave dhe të karrierës së punonjësve të këtij Shërbimi, trajtimi i punonjësve të këtij shërbimi, trajnimet, kriteret për ecurinë në karrierë, etj.	-	3.1 Shteti Ligjor dhe Drejtësia e re-Rendi dhe siguria publike	-
24	Projekt VKM "Miratimin e uniformes dhe shenjave dalluese të shërbimit të MZSH"	Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Akt nënligjor në zbatim të Ligjit 152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin" (neni 5)	Përcaktimi i uniformes dhe i shenjave dalluese të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi	-	-	-
25	Për përcaktimin e detyrimeve të transportuesit për transmetimin paraprak të Listës së Pasagjerëve sipas standardeve API	Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Përshtatja e legjislacionit shqiptar për sigurinë në kufi me Acquis të Schengen-it. Aplikimi i sistemit për informacionin e avancuar për pasagjeret (API), në përputhje me direktivën 2004/82 të BE, Rezolutave 2173 dhe 2309 të Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara dhe Standardit të ri të ICAO.	Aplikimi i sistemit për informacionin e avancuar për pasagjeret (API),	Po, Kapitulli 24	3.1 Shteti Ligjor dhe Drejtësia e re-Rendi dhe siguria publike	-
26	Projektligj "Për disa ndryshime në ligjin nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë"	Ministri i Brendshëm, Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori III	Ndryshimet që ka pësuar trafiku dhe qarkullimi i mjeteve në vend, adoptimi dhe përshtatja e normave të qarkullimit të vendeve të BE-se në kuadër të përafrimit të legjislacionit vendas me atë të BE-së	Modifikimi i normave të sjelljes duke përshtatur masat administrative me sjelljet në rrugë, në lidhje me shpejtësinë, alkoolin, përdorimin e celularit. Përshtatja e normave ekzistuese të transportit publik me dinamikat e reja të këtij transporti.	-	3.1 Shteti Ligjor dhe Drejtësia e Re, Rendi dhe Siguria Publike	Strategjia Kombëtare të Sigurisë Rrugore dhe me Planin e Veprimit përkatës
27	Për disa ndryshime në VKM nr. 741, datë 5.11.2014 "Për përcaktimin e kushteve, kritereve të përdorimit dhe kontrollit të fondit të posaçëm, në funksion të veprimtarisë hetimore dhe procesit informativ të SHÇBA, në Ministrinë e Punëve të Brendshme"	Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Fondi i posaçëm i Shërbimit, ndihmon në kryerjen e blerjeve sekrete, ose operacioneve të ndryshme në përmbushje të misionit dhe veprimtarisë së Shërbimit. Me ndryshimin e konceptimit të Shërbimit dhe shtimin e institucioneve mbi të cilat Shërbimi ushtron veprimtarinë e tij, dhe kuadri ligjor mbi fondin e posaçëm duhet ndryshuar për ti ardhur në ndihmë veprimtarisë së Shërbimit.	Parashikohet të ndryshojë, tavani I fondit të posaçëm që miratohet, mënyra e përdorimit dhe zgjerimi i fushës së përdorimit të këtij fondi	-	II.2 Lufta kundër korrupsionit	-
28	Për disa ndryshime në VKM nr.776, datë 19.11.2014 "Për disa të drejta të punonjësve të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat"	Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Me shtimin e detyrave dhe subjekteve që Shërbimi do të kontrolloje në kuadër të realizimit të misionit të tij, del nevoja e rregullimeve shtese mbi të drejtat e punonjësve të Shërbimit	Punonjës e Shërbimit, trajtohen në mënyrë të posaçme për sa i përket trajtimit me kompensim për largësi nga vendi i banimit, pagese për bashkëshortin që shkëputet nga puna, për shkak të transferimit të punonjësit, si dhe përcaktimi i lejes së zakonshme sipas gradave dhe funksioneve të punonjësve të Shërbimit	-	II.2 Lufta kundër korrupsionit	-
29	Për miratimin e Rregullores së Shërbimit Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme	Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Në kuadër të ndryshimeve që do të miratohen në ligjin 70/2014 "Për Shërbimin Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme". Ndryshimet e këtij ligji sjellin nevojën e përshtatjes së rregullores së Shërbimit, në zbatim të tij.	Kjo rregullore është e përbërë nga tre pjesë, organizimi dhe funksionimi, rregullore e personelit dhe rregullores e disiplinës. Përshtatja e tyre me ndryshimet ligjore do të bëjë më efektiv zbatimin e këtij ligji	-	II.2 Lufta kundër korrupsionit	-
30	"Për dhënien e ndihmës së menjëhershme financiare për punonjësit e MZSH në rastet e dëmtimit të rëndë të pronës për shkak të detyrës"	Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Akt nënligjor në zbatim të Ligjit 152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin" (neni 31)	Përcaktimi i kritereve dhe i procedurave që ndiqen për dhënien e ndihmës së menjëhershme financiare për punonjësit e MZSH-se	-	-	-

31	Për funksionimin dhe përdorimin e TIMS (*Total Information Management System)*	Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Rregullimin e përdorimin dhe mirëfunksionimin e TIMS ndërmjet ministrive/strukturave të ndryshme	Krijim e një baze ligjore që do të mundësojë krijimin dhe implementimin e një sistemi kërkimi të TIMS të vlefshëm për të gjitha strukturat/ ministritë	-	3.1.1 Administrata publike dhe digjitalizimi	Strategjisë së Policisë Shtetit 2015-2020.
32	Projekt VKM "Për mbrojtjen e veçantë të punonjësit të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi që, për shkak të detyrës, i kërcënohet jeta, familja dhe prona"	Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Akt nënligjor në zbatim të Ligjit 152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin" (neni 18)	Projektvendimi synon të garantojë mbrojtje të veçantë për punonjësin e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin kur për shkak të detyrës i kërcënohet jeta, familja, prona.	-	3.1 Shteti ligjor dhe drejtësia e re-rendi dhe siguria publike	-
33	"Mbi caktimin e sektorëve të shërbimeve policore që dëmtojnë shëndetin e nënës dhe fëmijës dhe përcaktimi i rregullave të veçanta për kushtet e punës për punonjëset e policisë që janë shtatzëna"	Ministri i Brendshëm, Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Katërmujori III	Detyrim që lind nga pika 3 e nenit 64 të Ligjit nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar.	Përcaktimi i sektorëve të shërbimeve policore që dëmtojnë shëndetin e nënës dhe fëmijës dhe përcaktimi i rregullave të veçanta për kushtet e punës për punonjëset e policisë që janë shtatzëna.	-	3.3 Shëndetësia dhe kujdesi social.	-
34	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.750, datë 16.9.2015, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit"	Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Miratimi i këtij projektvendimi është diktuar nga ndryshimet që solli Ligji nr.58/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.108/2014 "Për Policinë e Shtetit".	Projektvendimi ka për qëllim, të përshtatë rregullat e përcaktuara në Rregulloren e Policisë, me ndryshimet ligjore që solli ligjit nr.58/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", të ndryshuar	-	3.1 Shteti ligjor dhe drejtësia e re, rendi dhe siguria publike	Strategjia e Rendit Publik 2015-2020
35	Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës "Për ngritjen e pikave të Përbashkëta të Kalimit Kufitar Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës".	Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Në kuadër të bashkëpunimit kufitar ndërmjet dy vendeve	Ngritja dhe funksionimi i pikave të përbashkëta të kalimit kufitar	-	3.1 shteti ligjor dhe drejtësia e re-rendi dhe siguria publike	-
36	"Për tarifat për llojet e shërbimeve që ofrohen nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi".	Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Akt nënligjor në zbatim të Ligjit 152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin" (neni 36)	Projekt VKM ka për qëllim përcaktimin e tarifave për shërbimet shtesë në favor të shtetasve, subjekteve fizikë dhe juridikë që ofrohen nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin".	-	-	-
37	Për disa ndryshime në VKM nr.153 date 07.04.2000 "Rregullore për zbatimin e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë"	Ministri i Brendshëm, Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	Katërmujori III	Ndryshimet e pritshme të Kodit Rrugor në lidhje me ndryshimet që ka pësuar trafiku dhe qarkullimi i mjeteve në vend, adoptimi dhe përshtatja e normave të qarkullimit të vendeve të BE-se në kuadër të përafrimit të legjislacionit vendas me atë të BE, bëjnë të detyrueshëm ndryshimin e Rregullores.	Modifikimi i normave të sjelljes duke përshtatur masat administrative me sjelljet në rrugë, në lidhje me shpejtësinë, alkoolin, përdorimin e celularit dhe modifikimet e tjera do të kërkojë patjetër modifikimet Rregullores në normat e ndryshuara.	-	3.1 Shteti ligjor dhe drejtësia e re, rendi dhe siguria publike	Strategjia Kombëtare të Sigurisë Rrugore dhe me Planin e Veprimit përkatës

Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2019
Ministria e Drejtësisë

Nr.	Titulli i projektaktit	Ministri propozues dhe bashkëpropozues	Katër mujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	Lidhja me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian	Lidhja me programin qeverisës 2017-2021	Lidhja me strategjitë kombëtare dhe sektoriale
1	Projektligj "Për Shërbimin e Provës"	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori I	Në përputhje me garancitë dhe standardet që janë përcaktuar me ndryshimet e reja të Kodit I Drejtësisë për të Mitur.	Përmirësimi i veprimtarisë së institucionit. Nevojat e diktuara në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur	-	Projektligji është në përputhje me programin politik qeverisës. Pika 3.1 Shteti ligjor dhe drejtësia e re	-
2	Projektligj "Për funksionimin e kontrollit të brendshëm në sistemin e burgjeve, në Ministrinë e Drejtësisë"	Ministri i Drejtësisë	Katërmujori I	Është e nevojshme për përmirësimin dhe rikonceptimin e këtij shërbimi.	Përcaktimi i misionit, organizimi, funksionimi, pozitën juridike të SHKKBB-se si dhe statusin e punonjësit të këtij Shërbimi.	-	Projektligji është në përputhje me programin politik qeverisës. Pika 3.1 Shteti ligjor dhe drejtësia e re	-
